



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në mbështetje të nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.28 i Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligjin nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit dhe Ligjin Nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale, në takimin e mbajtur më 22 dhjetor 2023, miraton:

**RREGULLORE NR. 05/2023
PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORIT TË
SHTETIT TË KOSOVËS**

**KAPITULLI I
DISPOZITAT THEMELORE**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton organizimin e brendshëm, menaxhimin dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për të gjithë të punësuarit në institucionin e Prokurorit të Shtetit.

**Neni 3
Përkufizimet dhe shkurtesat**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1. **KPK** - Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- 1.2. **KPSH** - Kryeprokurori i Shtetit;
- 1.3. **ZKPSH** - Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;
- 1.4. **PSRK**- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës;
- 1.5. **PTH** – prokuroritë themelore;
- 1.6. **ZMNV** - Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave;

- 1.7. **ZRA** -- Zyra për Rikthimin e Aseteve;
- 1.8. **DKP** – Departamenti i Krimeve të Rënda;
- 1.9. **DM** – Departamenti për të Mitur;
- 1.10. **DP** – Departamenti i Përgjithshëm;
- 1.11. **Administrata** – stafi administrativ, joprokurorë.
- 1.12. **Të punësuarit** – nënkupton prokurorët dhe stafin administrativ.

Neni 4

Statusi dhe stema e Prokurorit të Shtetit

1. Prokurori i Shtetit ka statusin e personit juridik.
2. Prokurori i Shtetit përdor stemën e Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës.

Neni 5

Vula e Prokurorit të Shtetit

1. Të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara nga Prokurori i Shtetit duhet të përmbajnë vulën e Prokurorit të Shtetit.
2. Forma, përmbajtja dhe mënyra e përdorimit të vulës të Prokurorit të Shtetit rregullohen me akt të veçantë nënligjor.

KAPITULLI II

STRUKTURA DHE PËRGJEGJËSITË E PROKURORIT TË SHTESTIT

Neni 6

Organizimi i Prokurorisë së Shtetit

1. Prokurori i Shtetit organizohet dhe funksionon në pajtueshmëri me Kushtetutën, Ligjin për Prokurorin e Shtetit dhe Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, ligjet në fuqi dhe aktet nënligjore të KPK-së dhe ka këtë strukturë organizative:
 - 1.1. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;
 - 1.2. Prokuroria e Apelit, e cila përbëhet nga Departamenti i Përgjithshëm, Departamenti për të Mitur dhe Departamenti për Krime të Rënda;
 - 1.3. Prokuroria Speciale, e cila përbëhet nga departamentet e përhershme, si në vijim: Departamenti për Hetimin e Krimeve të Luftës, Departamenti për Hetimin e Krimit të Organizuar, Departamenti për Hetimin e Terrorizmit dhe Departamenti për Hetimin e Korrupsionit dhe Krimit Financiar.

- 1.4. Prokuroritë themelore përbëhen nga Departamenti i Përgjithshëm, Departamenti për të Mitur dhe Departamenti për Krime të Rënda.
2. Sipas nevojave të PSRK-së, Këshilli, me kërkesë të Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale dhe në konsultim me Kryeprokurorin e Shtetit, mund t'i shuajë departamentet aktuale apo të themelojë departamente të reja.
3. Në Prokurorinë Themelore të Prishtinës dhe në Prokurorinë Speciale janë paraparë me ligj udhëheqësit e departamenteve, të cilët caktohen nga KPK-ja me propozim të kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse.
4. Në kuadër të Prokurorisë Themelore të Prishtinës vepron Njësitë për Krime Ekonomike dhe Korrupsion në Departamentin e Krimeve të Rënda, njësitë ky, i cili është krijuar në bazë të strategjisë së KPK-së.

Neni 7 **Përgjegjësitë e Prokurorit të Shtetit**

1. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit është instanca më e lartë e Prokurorit të Shtetit me kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në ligj.
2. Prokuroria e Apelit vepron dhe përfaqëson lëndët në Gjykatën e Apelit dhe ka kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj. Prokuroria e Apelit ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
3. Prokuroria Speciale është organ prokurorial i specializuar, me juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.
4. Prokuroritë themelore ka juridiksion mbi të gjitha lëndët e shkallës së parë, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.

Neni 8 **Struktura organizative e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit**

1. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, ka këtë strukturë organizative:
 - 1.1 Kryeprokurori i Shtetit;
 - 1.2 Zëvendëskryeprokurori i Shtetit;
 - 1.3 Prokurorët;
 - 1.4 Bashkëpunëtorët profesionalë;
 - 1.5 Kabineti;
 - 1.6 Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar;
 - 1.7 Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave;
 - 1.8 Zyra për Informim dhe Komunikim Publik;
 - 1.9 Njësia Ndërlidhëse e Përgjimeve;
 - 1.10 Administrata.

Neni 9 Kompetencat dhe përgjegjësit e Kryeprokurorit të Shtetit

1. Kryeprokurori i Shtetit është kreu i Prokurorit të Shtetit dhe ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë, si në vijim:
 - 1.1. Është përgjegjës për menaxhimin dhe përfaqësimin e Prokurorit të Shtetit dhe të strukturave të prokurorive, të cilat e përbëjnë Prokurorinë e Shtetit;
 - 1.2. Është anëtar i Këshillit sipas detyrës zyrtare;
 - 1.3. I rekomandon Këshillit emërimin e Zëvendëskryeprokurorit të Shtetit, nga radhët e prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit;
 - 1.4. Mund t'i paraqesë Këshillit propozim për shkarkimin e Zëvendëskryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse;
 - 1.5. Ka kompetencë ekskluzive për lëndët në shkallë të tretë pranë Gjykatës Supreme dhe mbi të gjitha lëndët që përfshijnë mjetet e jashtëzakonshme juridike;
 - 1.6. Nxjerr me shkrim rregulla, udhëzime dhe vendime të përgjithshme të detyrueshme për të gjithë kryeprokurorët dhe prokurorët, me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit;
 - 1.7. Mbikëqyr zbatimin e udhëzimeve dhe akteve të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
 - 1.8. I propozon Këshillit për miratim rregullat mbi veprimtarinë dhe udhëheqjen e evidencës në Prokurorinë e Shtetit;
 - 1.9. Mund t'u japë udhëzime me shkrim Kryeprokurorit të një prokurorie apo cilindo prokuror të ndonjë prokurorie për punën konkrete, me qëllim të zhvillimit efikas të procedurës ose për arsye të tjera të rëndësishme kur konsideron se ka neglizhencë, paaftësi profesionale apo moszbatim të ligjshmërisë. Udhëzimet duhet të jenë të arsyetuara dhe të mos e cenojnë pavarësinë funksionale dhe profesionale të prokurorëve;
 - 1.10. Mund të kërkojë raporte apo informata të tjera me shkrim lidhur me progresin, gjendjen apo zgjidhjen e lëndëve të caktuara. Kërkesa e tillë duhet të bëhet me shkrim;
 - 1.11. Bën vlerësimin e punës së kryeprokurorëve dhe prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit;
 - 1.12. Kërkon vlerësimin e jashtëzakonshëm të kryeprokurorëve dhe prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit;
 - 1.13. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligje apo akte nënligjore.
2. Kryeprokurori i Shtetit me vendim me shkrim, me qëllim të zhvillimit efikas të procedurës ose për arsye të tjera të rëndësishme, mund të marrë nën juridiksion cilindo rast në cilëndo

prokurori në Republikën e Kosovës ose ta ricaktojë atë të një prokurori tjetër. Vendimi me shkrim duhet të arsyetohet së paku edhe neglizhencën, paaftësinë profesionale ose konfliktin e interesit.

Neni 10 **Zëvendëskryeprokurori i Shtetit**

1. Në rast të mungesës apo përfundimit të mandatit të Kryeprokurorit të Shtetit, Zëvendëskryeprokurori i Shtetit ushtron të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Kryeprokurorit të Shtetit, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
2. Kur Kryeprokurori i Shtetit është në detyrë, Zëvendëskryeprokurori i Shtetit ushtron funksionin e prokurorit.

Neni 11 **Prokurorët e Shtetit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit**

Prokurorët e Shtetit në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit ushtrajnë funksionin në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe autorizimet e Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 12 **Bashkëpunëtorët profesionalë në ZKPSH**

1. Bashkëpunëtorët profesionalë kanë për detyrë të ofrojnë mbështetje profesionale për përmbushjen e detyrave të prokurorëve të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.
2. Bashkëpunëtori Profesional për punën e tij profesionale i përgjigjet Kryeprokurorit të Shtetit, ndërsa për çështje teknike dhe administrative i përgjigjet Administratorit.
3. Vlerësimi i performancës së Bashkëpunëtorit Profesional bëhet nga Administratori, në konsultim me prokurorët e Zyrës dhe Kryeprokurorin e Shtetit.
4. Procedura e përzgjedhjes, emërimit, kriteret, të drejtat dhe detyrimet për bashkëpunëtorë profesionalë është e rregulluar me rregullore të veçantë.

Neni 13 **Kabineti i Kryeprokurorit të Shtetit**

1. Kabineti ofron mbështetje profesionale dhe administrative për Kryeprokurorin e Shtetit dhe ka këtë strukturë organizative:
 - 1.1 Shefi i Kabinetit;
 - 1.2 Katër (4) këshilltarë të Kryeprokurorit të Shtetit;
 - 1.3 Zyrtar i Sigurisë;
 - 1.4 Zyrtar i Protokollit;
 - 1.5 Asistenti Ekzekutiv i Kryeprokurorit të Shtetit;

- 1.6 Asistenti Administrativ i Kryeprokurorit të Shtetit dhe
- 1.7 Zyrtari i Transportit.

- 2. Zyrtarët e kabinetit janë kategori e veçantë e zyrtarëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.
- 3. Zyrtarët e kabinetit emërohen dhe shkarkohen nga Kryeprokurori i Shtetit dhe për veprimet e tyre i përgjigjen Kryeprokurorit të Shtetit.
- 4. Janë të obliguar të demonstrojnë përkushtim ndaj Kryeprokurorit të Shtetit dhe institucionit të Prokurorit Shtetit.
- 5. Staf i Kabinetit të Kryeprokurorit të Shtetit nuk ushtron kompetenca drejtuese ose kompetenca të tjera administrative në organet e larta të administratës prokuroriale.
- 6. Të gjitha emërimet e zyrtarëve të kabinetit lidhen me mandatin e Kryeprokurorit të Shtetit, përveç Zyrtarit të Protokollit, i cili vjen nga radha e zyrtarëve publikë. Mandati i tyre pushon edhe më herët, në qoftë se Kryeprokurori i Shtetit vendos për një gjë të tillë.
- 7. Emërimi mund të ndërpritet duke u njoftuar paraprakisht një muaj më herët ose pa dërguar njoftim nëse ka arsye të rëndësishme.
- 8. Paga e të punësuarve në kabinet, sipas paragrafit 1 të këtij neni, caktohet me akt të veçantë nga KPK-ja me propozim të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 14

Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar

- 1. Kryeprokurori i Shtetit cakton një prokuror të shtetit nga ZKPSH-ja në detyrën e Udhëheqësit të Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe mund të caktojë prokurorë të tjerë dhe staf mbështetës profesional dhe administrativ.
- 2. Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar ka detyra dhe përgjegjësi për ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare dhe çështje të tjera të karakterit ndërkombëtar në kuadër të autorizimeve ligjore të Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës.
- 3. Në ushtrimin e mandatit të saj, Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar koordinohet me institucionet relevante.

Neni 15

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

- 1. Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave është zyrë e pavarur për ofrimin e shërbimeve për viktimat e krimit gjatë procedurave ligjore dhe përfaqësimin e interesave të tyre në sistemin e drejtësisë penale.
- 2. Prokurorët e shtetit dhe mbrojtësit e viktimave, të caktuar për përfaqësim të të drejtave të viktimave kanë për obligim që gjatë procedurës të koordinojnë ngushtë aktivitetet me njëri tjetrin në përfaqësimin e interesave, çështjeve dhe kërkesave të viktimave.

3. Mandati, struktura, funksionimi dhe organizimi i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave rregullohet me rregullore të veçantë.

Neni 16
Zyra për Rikthimin e Aseteve

1. Zyra për Rikthimin e Aseteve shërben si qendër e ekspertizës për të dhënë këshilla dhe informata sipas kërkesës së prokuroreve të rastit, në lidhje me veprimet hetimore sa i përket gjurmimit dhe identifikimi i asetëve.
2. Mandati, struktura, funksionimi dhe organizimi i Zyrës për Rikthimin e Aseteve rregullohet me rregullore të veçantë.

Neni 17
Zyra për Komunikim Publik

1. Zyra për Komunikim Publik në kuadër të ZKPSH-së udhëhiqet nga Udhëheqësi i Zyrës dhe ka këtë strukturë organizative:
 - 1.1. Udhëheqësi i Zyrës;
 - 1.2. Zyrtari për Komunikim Publik;
 - 1.3. Zyrtari për Informim dhe Monitorim të Mediave.
2. Detyra dhe përgjegjësit kryesore të Zyrës për Komunikim Publik janë të rregulluara me rregullore të veçantë.
3. Udhëheqësi i Zyrës për punën e tij profesionale i përgjigjet Kryeprokurorit të Shtetit, ndërsa për çështje teknike dhe administrative i përgjigjet Administratorit.
4. Vlerësimi i performancës së Udhëheqësit të Zyrës bëhet nga Administratori në koordinim me Kryeprokurorin e Shtetit.
5. Vlerësimi i performancës së të punësuarve nga paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 bëhet nga Udhëheqësi i Zyrës në koordinim me Administratorin.

Neni 18
Njësia Ndërlidhëse e Përgjimeve

1. Njësia Ndërlidhëse e Përgjimeve është themeluar me ligj në kuadër të ZKPSH-së, me të cilën rregullohet procedura në procesin e përgjimit ligjor, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve të autorizuar në procesin e përgjimit.
2. Struktura dhe funksionimi i Njesisë Ndërlidhës të Përgjimeve është rregulluar me rregullore të veçantë.

Neni 19
Administrata e ZKPSH-së

1. Administrata e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit ofron mbështetje administrative dhe ka këtë strukturë organizative:
 - 1.1. Administratori;
 - 1.2. Zyra për Menaxhimin e Lëndëve;
 - 1.3. Zyra për Mbështetje Juridike dhe
 - 1.4. Zyra për Shërbime të Përgjithshme.

Neni 20
Administratori në ZKPSH

1. Administratori është udhëheqës i administratës në ZKPSH.
2. Administratori i ZKPSH-së menaxhon dhe mbikëqyrë funksionet administrative të prokurorisë, në bashkëpunim me Kryeprokurorin e Shtetit dhe në koordinim me Sekretariatit e Këshillit Prokurorial.
3. Përkujdeset për sigurimin e mjeteve adekuate për punë, siguron mbështetje dhe respektim të procedurave dhe rregullave të parapara me legjislacionin në fuqi.
4. Vlerësimi i performancës së Administratorit bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së në koordinim me Kryeprokurorin e Shtetit.
5. Në mungesë të Administratorit, detyrën e tij do ta ushtrojë përkohësisht udhëheqësi i cili për nga hierarkia është pozitë më e lartë pas tij.

Neni 21
Zyra për Menaxhimin e Lëndëve

1. Zyra për Menaxhimin e Lëndëve në kuadër të ZKPSH udhëhiqet nga Udhëheqësi i Zyrës dhe ka këtë strukturë organizative:
 - 1.1 Udhëheqësi i Zyrës;
 - 1.2 Referenti i Pranimi;
 - 1.3 Referenti i Regjistrimit;
 - 1.4 Zyrtari për Arkiv dhe
 - 1.5 Zyrtari për Distribimin e Dokumenteve.
2. Zyra për Menaxhimin e Lëndëve është përgjegjëse për pranimin, regjistrimin, dorëzimin, menaxhimin, ekzekutimin, arkivimin dhe raportimin statistikor të lëndëve në prokurori, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të nxjerra nga Këshilli.
3. Udhëheqësit i Zyrës për punën e tij i përgjigjet Administratorit dhe Kryeprokurorit të Shtetit.

4. Vlerësimi i performancës së Udhëheqësit të Zyrës bëhet nga Administratori.
5. Vlerësimi i performancës i të punësuarve në paragrafin 1, nënparagrafin 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 bëhet nga Udhëheqësi i Zyrës në koordinim me Administratorin.

Neni 22
Zyra për Mbështetje Juridike

1. Zyra për Mbështetje Juridike në kuadër të ZKPSH-së udhëhiqet nga Udhëheqësi i Zyrës dhe ka këtë strukturë organizative:
 - 1.1 Udhëheqësi i Zyrës dhe
 - 1.2 Zyrtari Ligjor - Sekretar Juridik.
2. Zyra për Mbështetje Juridike është përgjegjëse për të mbështetur punën e prokurorisë gjatë përgatitjes së lëndës sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore, të nxjerra nga Këshilli.
3. Udhëheqësi i Zyrës i përgjigjet për punën e tij Administratorit dhe Kryeprokurorit të Shtetit.
4. Vlerësimi i performancës së Udhëheqësit të Zyrës bëhet nga Administratori në koordinim me Kryeprokurorin e Shtetit.
5. Vlerësimi i performancës i të punësuarve sipas paragrafit 1, nënparagrafi 1.2 bëhet nga Udhëheqësi i Zyrës në koordinim me prokurorin përkatës dhe Administratorin.

Neni 23
Zyra për Shërbime të Përgjithshme

1. Zyra për Shërbime të Përgjithshme në kuadër të ZKPSH-së udhëhiqet nga Udhëheqësi i Zyrës dhe ka këtë strukturë organizative:
 - 1.1 Udhëheqësi i Zyrës;
 - 1.2 Zyrtari i Përkthimi;
 - 1.3 Zyrtari Financiar;
 - 1.4 Zyrtari i Logjistikës;
 - 1.5 Zyrtar i TI-së;
 - 1.6 Zyrtari i SMIL-it;
 - 1.7 Zyrtari për Transport;
 - 1.8 Zyrtar Teknik i Kontrollit dhe Mirëmbajtësit;
 - 1.9 Zyrtari për Siguri;
 - 1.10 Asistenti për Shërbime të Sigurisë dhe
 - 1.11 Receptonisti.
2. Zyra për Shërbime të Përgjithshme është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të parapara sipas nenit 22, paragrafit 1.

3. Udhëheqësi i Zyrës për punën e tij i përgjigjet Administratorit të Prokurorisë dhe Kryeprokurorit të Shtetit.
4. Vlerësimi i performancës së Udhëheqësit të Zyrës bëhet nga Administratori në koordinim me Kryeprokurorin e Shtetit.
5. Të punësuarit nga paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10 dhe 1.11 i përgjigjen Udhëheqësit të Zyrës dhe Administratorit.
6. Vlerësimi i performancës së punës për stafin e Zyrës bëhet nga Udhëheqësi i Zyrës në koordinim me Administratorin.

Neni 24

Struktura organizative e Zyrës së Prokurorisë së Apelit, Prokurorisë Speciale dhe prokurorive themelore

1. Zyrat e kryeprokurorëve të prokurorive në kuadër të Prokurorisë së Apelit, Prokurorisë Speciale dhe prokurorive themelore kanë këtë strukturë organizative:
 - 1.1. Kryeprokurori;
 - 1.2. Zëvendëskryeprokurori;
 - 1.3. Prokurorët dhe
 - 1.4. Administrata.

Neni 25

Zyra e Kryeprokurorit

5. Zyra e Kryeprokurorit përbëhet nga:
 - 5.1. Kryeprokurori;
 - 5.2. Zëvendëskryeprokurori;
 - 5.3. Udhëheqësit e departamenteve për Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe PSRK-në;
 - 5.4. Prokurorët;
 - 5.5. Bashkëpunëtorët profesionalë;
 - 5.6. Zyrtari për komunikim publik dhe
 - 5.7. Ekspertët.

KAPITULLI III PËRGJËGJËSIT DHE DETYRAT

Neni 26

Kryeprokurori i Prokurorisë

1. Kryeprokurori është kreu i prokurorisë përkatëse dhe ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë si në vijim:

- 1.1. udhëheqë punën dhe përfaqëson prokurorinë, për të cilin është emëruar;
 - 1.2. është përgjegjës për punën e prokurorisë dhe për punën e vet për çështje administrative i përgjigjet Këshillit, ndërkaq për çështje operative i përgjigjet Kryeprokurorit të Shtetit;
 - 1.3. i rekomandon Këshillit Zëvendëskryeprokurorin e tij;
 - 1.4. mund t'i paraqesë Këshillit propozim për shkarkimin e Zëvendëskryeprokurorit të tij;
 - 1.5. mund të marrë përsipër funksionin e ndjekjes penale në një lëndë konkrete që iu ka caktuar një prokurori vartës në atë prokurori me pëlqimin paraprak të Kryeprokurorit të Shtetit. Marrja e rastit duhet të bëhet me vendim të arsyetuar;
 - 1.6. mund të kërkojë raporte me shkrim apo informata nga prokurori vartës;
 - 1.7. mund të delegojë disa kompetenca te vartësit e tij;
 - 1.8. mund t'u japë udhëzime me shkrim prokurorëve të prokurorisë që udhëheq, me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit. Udhëzimet duhet të jenë të arsyetuara, të mos cenojnë pavarësinë funksionale dhe profesionale të prokurorëve. Nëse prokurori e konsideron udhëzimin si të kundërligjshëm ose në kundërshtim me ndërgjegjshmerinë e tij, ai ka të drejtë të kërkojë vendimin e Kryeprokurorit të Shtetit. Vendimi i Kryeprokurorit të Shtetit është me shkrim dhe përfundimtar;
 - 1.9. bën vlerësimin e punës së prokurorëve të prokurorisë që udhëheq;
 - 1.10. kërkon vlerësimin e jashtëzakonshëm të performancës së prokurorëve të prokurorisë që udhëheq;
 - 1.11. kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore.
2. Përveç kompetencave dhe përgjegjësiave të përcaktuara në paragrafin I të këtij neni, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë i propozojnë Këshillit caktimin dhe shkarkimin e udhëheqësve të departamenteve, siç përcaktohet me ligj.
 3. Kryeprokuroret i prokurorisë përkatëse, me qëllim të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë mund të caktojë sipas nevojës edhe prokurorë përgjegjës dhe koordinatorë në departamentet përkatëse.

Neni 27
Zëvendëskryeprokurori i Prokurorisë

1. Në rast të mungesës apo përfundimit të mandatit të Kryeprokurorit të Prokurorisë, Zëvendëskryeprokurori ushtron të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Kryeprokurorit të Prokurorisë, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
2. Kur Kryeprokurori i Prokurorisë është në detyrë, Zëvendëskryeprokurori ushtron funksionin e prokurorit.

Neni 28
Prokurorët e Shtetit

Prokurorët e Shtetit ushtrojnë funksionin e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi, sipas prokurorisë përkatëse dhe departamentit përkatës, ku janë të caktuar.

Neni 29
Udhëheqësit e departamenteve

1. Sipas ligjit për Prokurorin e Shteti dhe ligjeve në fuqi, udhëheqësit e departamenteve kanë këto përgjegjësi:
 - 1.1. janë përgjegjës për rregullimin e brendshëm dhe funksionimin e departamentit;
 - 1.2. sipas kërkesës, ofrojnë këshilla dhe rekomandime në raport me lëndët për prokurorët;
 - 1.3. i raportojnë Kryeprokurorit të Prokurorisë për punën e departamentit që udhëheq;
 - 1.4. kujdesen për mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit të punës së prokurorëve për periudha gjashtë (6) mujore dhe një (1) vjeçare;
 - 1.5. ushtrojnë funksionin e prokurorit sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Përveç përgjegjësiave të përcaktuara me ligj kanë edhe këto detyra:
 - 2.1. udhëheqësit e departamenteve zbatojnë rregullat dhe udhëzimet e Kryeprokurorit të Prokurorisë brenda Departamentit dhe dorëzojnë raporte tremujore për punën e departamentit tek Kryeprokurori i prokurorisë.
 - 2.2. udhëheqësit e departamenteve paraqesin rekomandime te Kryeprokurori i prokurorisë për të gjitha çështjet që i përkasin punës së Departamentit.
 - 2.3. udhëheqësit janë llogaridhënës për punën e tyre.

Neni 30
Përgjegjësitë e departamenteve në prokuroritë e tjera

1. Kryeprokurorët i prokurorisë përkatëse, me qëllim të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë mund të caktojnë sipas nevojës edhe prokurorë përgjegjës dhe koordinatorë në departamentet përkatëse.

2. Detyrat e prokurorit të caktuar, sipas paragrafi 1, përcaktohen me vendim të veçantë të Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse.

Nen 31

Bashkëpunëtorët profesionalë në Prokurori

1. Bashkëpunëtorët profesionalë kanë për detyrë të ofrojnë mbështetjet profesionale për përmbushjen e detyrave të prokurorëve.
2. Bashkëpunëtori profesional për punën e tij profesionale i përgjigjet prokurorit përkatës, ndërsa për çështje teknike dhe administrative i përgjigjet Administratorit.
3. Vlerësimi i performancës së bashkëpunëtorëve profesionalë bëhet nga Administratori në konsultim me prokurorin përkatës dhe Kryeprokurorin.

4. Procedura e përzgjedhjes dhe emërimit, kriteret, të drejtat dhe detyrimet për bashkëpunëtorë profesionalë është e rregulluar me rregullore të veçantë.

Neni 32

Ekspertët

1. Ekspertët kanë për detyrë të ofrojnë mbështetje profesionale për shqyrtimin në mënyrë profesionale dhe për analizë të dokumentacionit përkatës të rasteve të paraqitura në Prokurori.
2. Ekspertët për punën e tyre profesionale i përgjigjen Kryeprokurorit, ndërsa për çështje administrative i përgjigjen Administratorit.
3. Vlerësimi i performancës së ekspertëve bëhet nga Administratori në koordinim me Kryeprokurorin.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertëve janë të përcaktuara në përshkrimin e detyrave të punës.

Neni 33

Zyrtar për Komunikim Publik

1. Zyrtari për Komunikim Publik është i obliguar të njoftojë opinionin publikun me punët dhe aktivitetet e prokurorisë.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Zyrtarit për Komunikim Publik janë të përcaktuara me rregullore të veçantë dhe përshkrim të detyrave të punës.
3. Zyrtari për Komunikim Publik për punën e tij profesionale i përgjigjet Kryeprokurorit, ndërsa për çështje teknike dhe administrative i përgjigjet Administratorit.
4. Vlerësimi i performancës së Zyrtarit për Komunikim Publik bëhet nga Administratori, në konsultim me Kryeprokurorin.

Neni 34 Administrata

1. Administrata ndihmon Kryeprokurorin në administrimin e punëve të prokurorisë dhe ka këtë strukturë organizative:

- 1.1. Administratori;
- 1.2. Ndihmësadministratori për Prokurorinë Themelore në Mitrovicë;
- 1.3. Zyra për Menaxhimin e Lëndëve;
- 1.4. Zyra për Mbështetje Juridike dhe
- 1.5. Zyra për Shërbime të Përgjithshme.

Neni 35 Administratori

1. Administratori është udhëheqës i administratës në prokurorinë përkatës.
2. Administratori i Prokurorisë menaxhon dhe mbikëqyrë funksionet administrative të prokurorisë, në bashkëpunim me Kryeprokurorin dhe në koordinim me Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së.
3. Përkujdeset për sigurimin e mjeteve adekuate për punë, siguron mbështetje dhe respektim të procedurave dhe rregullave, të parapara me legjislacionin në fuqi dhe i raporton Kryeprokurorit.
4. Vlerësimi i performancës së Administratorit bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së në koordinim me Kryeprokurorin.
5. Në mungesë të administratorit të prokurorisë, detyra e tij do të ushtrohet përkohësisht nga udhëheqësi i cili për nga hierarkia është pozitë më e ulët sesa Administratori.
6. Përrjashtimisht, në mungesë të Administratorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, detyrat e tij do të ushtrohen përkohësisht nga Ndihmësadministratori.

Neni 36 Ndihmësadministratori në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë

1. Ndihmësadministratori e Prokurorisë kryen punë, të cilat iu kanë besuar nga kryeprokurori në pajtim me këtë rregullore.
2. Ndihmësadministratori ka autoritet të plotë për të vepruar në emër të Administratorit në rast të mungesës apo pengesës së tij që të ushtrojë detyrat dhe përgjegjësit e tij, si dhe kryen punë në bazë të fushëveprimit dhe autorizimeve të Administratorit.
3. Kriteret, procedurat dhe emërimi i Ndihmësadministratorit janë të njëjta sikurse ato për Administratorin.

Neni 37
Zyra për Menaxhimin e Lëndëve

1. Zyra për Menaxhimin e Lëndëve udhëhiqet nga Udhëheqësi i Zyrës dhe ka këtë strukturë organizative:
 - 1.1. Udhëheqësi i Zyrës;
 - 1.2. Referenti i Pranimit;
 - 1.3. Referenti i Regjistrimit;
 - 1.4. Zyrtari për Arkiv;
 - 1.5. Zyrtari për Distribim të Dokumenteve.
2. Zyra për Menaxhimin e Lëndëve është përgjegjëse për pranimin, regjistrimin, dorëzimin, menaxhimin, ekzekutimin, arkivimin dhe raportimin statistikor të lëndëve në prokurori, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe rregulloreve të nxjerra nga Këshilli.
3. Udhëheqësit i Zyrës për punën e tij i përgjigjet Administratorit dhe Kryeprokurorit.
4. Vlerësimi i performancës së Udhëheqësit të Zyrës bëhet nga Administratori.
5. Vlerësimi i performancës i të punësuarve në paragrafin 1, nënparagrafin 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 bëhet nga Udhëheqësi i Zyrës në koordinim me Administratorin.

Neni 38
Zyra për Mbështetje Juridike

1. Zyra për Mbështetje Juridike udhëhiqet nga Udhëheqësi i Zyrës dhe ka këtë strukturë organizative:
 - 1.1. Udhëheqësi i Zyrës
 - 1.2. Zyrtar Ligjore/Sekretare Juridike dhe
 - 1.3. Referent për Ndërmjetësim në prokuroritë themelore.
2. Zyra për Mbështetje Juridike është përgjegjëse për të mbështetur punën e prokurorisë gjatë përgatitjes së lëndës sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore të nxjerra nga Këshilli.
3. Udhëheqësi i Zyrës për punën e tij i përgjigjet Administratorit dhe Kryeprokurorit.
4. Vlerësimi i performancës së Udhëheqësit të Zyrës bëhet nga Administratori në koordinim me Kryeprokurorin.
5. Vlerësimi i performancës i të punësuarve sipas paragrafit 1, nënparagrafit 1.2 dhe 1.3 bëhet nga Udhëheqësi i Zyrës në koordinim me prokurorin përkatës dhe Administratorin.

Neni 39
Zyra për Shërbime të Përgjithshme

1. Zyra për Shërbime të Përgjithshme udhëhiqet nga Udhëheqësi i Zyrës dhe ka këtë strukturë organizative :
 - 1.1. Udhëheqësi i Zyrës;
 - 1.2. Zyrtari për Përkthim;
 - 1.3. Zyrtari për Financa;
 - 1.4. Zyrtari për Logjistikë;
 - 1.5. Zyrtari për TI-në;
 - 1.6. Zyrtari për SMIL;
 - 1.7. Zyrtar për Transport;
 - 1.8. Zyrtari Teknik i Kontrollit dhe Mirëmbajtjes;
 - 1.9. Zyrtari për Siguri;
 - 1.10. Asistenti për Shërbime të Sigurisë dhe
 - 1.11. Receptacionisti.
2. Zyra për Shërbime të Përgjithshme është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të parapara sipas nenit 22, paragrafit 1.
3. Udhëheqësi i Zyrës për punën e tij i përgjigjet Administratorit të Prokurorisë dhe Kryeprokurorit.
4. Vlerësimi i performancës së Udhëheqësit të Zyrës bëhet nga Administratori në koordinim me Kryeprokurorin.
5. Të punësuarit nga paragrafi 1, nënparagrafët 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10 dhe 1.11 i përgjigjen dhe i raportojnë Udhëheqësit të Zyrës dhe Administratorit.
6. Vlerësimi i performancës së punës për stafin e Zyrës bëhet nga Udhëheqësi i Zyrës në koordinim me Administratorin.

Neni 40
Praktikantët

Praktikantët nuk e kanë statusin e zyrtarëve publikë dhe përgjegjësitë dhe detyrat e tyre rregullohet me rregullore të veçantë.

KAPITULLI IV
ORGANIZIMI I PUNËS SË PROKURORIT TË SHQETIT

Neni 41
Kolegjiumi i Kryeprokurorëve

1. Kolegjiumi i Kryeprokurorëve mbahet në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe përbëhet nga kryeprokurorët e të gjitha prokurorive.

2. Kryeprokurori cakton një zyrtar përgjegjës për mbështetjen teknike dhe administrative të kolegjiut të kryeprokurorëve.
3. Kolegjiut i Kryeprokurorëve mbahet së paku njëherë në muaj dhe sipas nevojës edhe më shpesh.
4. Kolegjiut i Kryeprokurorëve shqyrton çështjet e punës dhe veprimtarisë së Prokurorit të Shtetit.

Neni 42 **Kolegjiut i Prokurorëve**

1. Kolegjiut i Prokurorëve përbëhet nga të gjithë prokurorët e prokurorisë përkatëse dhe udhëhiqet nga kryeprokurori. Administratori dhe zyrtarët e prokurorisë që merren me çështje ligjore mund të jenë të pranishëm në mbledhjet e kolegjiut, vetëm në cilësi të vëzhguesit, pa të drejtë vote.
2. Kolegjiut i Prokurorëve mbahet së paku dy herë në muaj, sipas nevojës, edhe më shpesh.
3. Kolegjiut i Prokurorëve shqyrton çështjet e punës dhe veprimtarisë së prokurorisë, duke përfshirë rezultatet e arritura të punës në periudhën paraprake, lëndët nga vitet paraprake, ngarkesën e prokurorëve me lëndë, numrin e lëndëve të kryera dhe të pakryera sipas prokurorëve, mundësitë e avancimit të metodave të punës, çështje të tjera të rëndësishme për punën e prokurorisë, si dhe çështjet që vetë prokurorët e shtetit kërkojnë të trajtohen.
4. Gjatë marrjes së vendimeve për planin vjetor të punës dhe vendimet e tjera të rëndësishme, të gjithë prokurorët e prokurorisë përkatëse duhet të marrin pjesë në Kolegjiutin e Prokurorëve.
5. Kolegjiut i Prokurorëve udhëhiqet nga kryeprokurori i prokurorisë përkatëse. Në mungesë të kryeprokurorit, Kolegjiutin e udhëheq zëvendësit i tij.
6. Administratori i prokurorisë përkatëse mbështet punën e Kryeprokurorit në organizimin dhe mbarëvajtjen e takimit të Kolegjiut.
7. Rendi i ditës i takimit të Kolegjiut u shpërndahet prokurorëve të paktën tri (3) ditë para takimit të radhës.
8. Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse cakton një bashkëpunëtor profesional për mbajtjen e procesverbalit të takimeve në Kolegjiut.
9. Në fund të çdo viti kalendarik, të gjitha dokumentet në lidhje me takimet e Kolegjiut arkivohen vendosen në dosje të veçantë me emrin "Takimet e Kolegjiut".
10. Sipas nevojës, do të ketë takime të Kolegjiut të Zgjeruar, i cili përbëhet nga Kryeprokurori i Shtetit, prokurorët e ZKPSH-së dhe kryeprokurorëve e të gjitha prokurorisë, në të cilin do të shqyrtohen çështje të ndryshme profesionale, si dhe unifikimi i praktikave në prokurori.

Neni 43
Konferenca Vjetore e Prokurorëve

1. Konferenca Vjetore e Prokurorëve mbahet çdo vit.
2. Datën e saktë të Konferencës Vjetore e cakton Kryeprokurori i Shtetit me rastin e thirrjes së kësaj konference.
3. Kryeprokurori i Shtetit përcakton rendin e ditës në konsultim me kryeprokurorët e prokurorive të Republikës së Kosovës.

Neni 44
Plani Vjetor i Punës

1. Prokurori i Shtetit ka Planin vjetor të Punës, i cili hartohet për çdo vit kalendarik.
2. Plani i Punës përmban detyrat dhe punët nga kompetencat e Prokurorit të Shtetit, të cilat duhet të kryhen brenda vitit përkatës.

Neni 45
Hartimi i Planit Vjetor

1. Plani i Punës hartohet nga ZKPSH-ja, në konsultim me të gjitha prokuroritë.
2. Plani i Punës për vitin vijues duhet të aprovohet më së largu deri në fund të vitit paraparak.
3. ZKPSH-ja përcakton një formë së bashku me parimet dhe udhëzimet për Planin e Punës, i cila brenda periudhës të përshtatshme kohore i dërgohet të gjitha prokurorëve për vendosjen e prioriteteve dhe detyrave të tyre për vitin vijues.
4. Kryeprokurorët përkatës sigurohen që procesi i hartimit të Planit të Punës, respektivisht përcaktimi i prioriteteve dhe detyrave të zyrës së tyre, të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe që të gjithë prokurorët e zyrës përkatëse dhe stafi tjetër relevant të marrë pjesë në hartimin e të njëjtit.
5. Për qëllime të paragrafit 4 të këtij neni, kryeprokurorët organizojnë takime të kolegjiutit dhe takime të tjera të nevojshme.
6. Plani i Punës nënshkruhet nga Kryeprokurori i Shtetit dhe shpërndahe tek të gjitha prokuroritë, me udhëzime të qarta për mënyrën e zbatimit të njëjtit dhe udhëzime për raportim në lidhje me zbatimin e Planit të Punës.
7. Kryeprokurori i Shtetit e njofton Këshillin për planin e punës dhe përmbajtjen e të njëjtit.

Neni 46
Përmbajtja e Planit të Punës

1. Në Planin e Punës në mënyrë të përafërt përcaktohet orari, vëllimi, mënyra dhe afati i kryerjes së punëve të përcaktuara dhe punëve të tjera që janë në program.

2. Në Planin e punës caktohet orari vjetor i punëve për prokurorët dhe stafin brenda prokurorisë, sipas departamenteve.

Neni 47

Ndryshimi i Planit të Punës

1. Me kërkesë të Kryeprokurorit të një prokurorie, Plani i Punës mund të ndryshohet nga Kryeprokurori i Shtetit.
2. Arsytet për të kërkuar ndryshimin e Planit të Punës përfshijnë, ndër të tjera, rritjen e fluksit të lëndëve, mungesën e gjatë të prokurorëve apo stafit profesional në puna, përcaktimin e prioriteteve shtesë nga KPK-ja ose për arsye të tjera.

Neni 48

Buletini dhe Qëndrimet Juridike

1. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit për nevojat e veta publikon Buletinin për çështjet si në vijim:
 - 1.1 për lëndë të komplikuar penale që janë paraqitur në punën e Prokurorit të Shtetit;
 - 1.2 udhëzime të karakterit të përgjithshëm të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe
 - 1.3 vendime të rëndësishme të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Gjykatës Supreme të Kosovës, por edhe të gjykatave të tjera të rëndësishme për praktikën e punës së prokurorëve.

Neni 49

Pushimi Vjetor

1. Prokurorët dhe stafi i punësuar në institucionin e Prokurorit të Shtetit kanë të drejtë në pushim vjetor në masë të barabartë me legjislacionin në fuqi, që rregullon marrëdhënien e punës.
2. Orari i pushimeve vjetore planifikohet për secilën prokurori në atë mënyrë që të sigurohet që gjithnjë ka numër të mjaftueshëm të prokurorëve dhe stafit në punë.

Neni 50

Biblioteka Juridike

1. Prokurori i Shtetit ka bibliotekën e vet profesionale.
2. Nëse në një ndërtesë ekzistojnë shumë prokurori, biblioteka mund të organizohet si e përbashkët për të gjitha këto prokurori.
3. Biblioteka profesionale përmban, ndër të tjera, ligjet, akte e tjera ligjore, literaturën profesionale, revistat e ndryshme, gazetën zyrtare, publikimet e praktikës prokuroriale-gjyqësore dhe buletine të ndryshme.

4. Të gjitha dokumentet e përmendura në paragrafin 3 janë të vendosura në bibliotekën online në kuadër të uebportalit.
5. Organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës Juridike do të përcaktohet me një akt nënligjor nga ana e Këshillit.

Neni 51 Tabela e Shpalljeve

1. Prokuroritë në Tabelën e Shpalljeve shpallin njoftimet që nuk mund t'i komunikojnë në pajtim me dispozitat e Ligji për Prokurorin e Shtetit.
2. Tabela e Shpalljeve vendoset në godinat e prokurorive në një vend të dukshëm, ku qasja për të gjithë është më e lehtë.

KAPITULLI V DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 52 Organogramët

Organogrami i Prokurorit të Shtetit, Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Prokurorisë së Apelit, Prokurorisë Speciale dhe prokurorive themelore pasqyrojnë strukturën dhe organizimin e institucionit të Prokurorit të Shtetit dhe janë pjesë integrale e kësaj rregulloreje, të paraqitur në Shtojcën 1.

Neni 53 Planifikimi i pozitave të prokurorëve dhe stafit administrativ

1. Planifikimi i të gjitha pozitave në sistemin prokurorial, caktimi e numrit të stafit, duke përfshirë edhe përshkrimin e vendit të punës bëhet nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.
2. Përshkrimi i vendeve të punës dhe përcaktimi i niveleve të gradës të stafit administrativ do të jetë në Shtojcën 2.
3. Me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së dhe me vendim të KPK-së mund të krijohen pozita të reja të punës.

Neni 54 Shfuqizimi


Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja nr.11/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Funksionimin e Prokurorit të Shtetit të Kosovës.

Neni 55
Hyrja në fuqi


Kjo rregullore hyn në fuqi nga data 01 prill 2024 nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë, më 22 dhjetor 2023


Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës




Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit



Prokuroria e Apelit



Prokuroria Speciale



Prokuroritë Themelore

